



Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 7986 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40, Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike 03/L-048 neni 45.4, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 75, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2016 merr:

VENDIM

PËR

MIRATIMIN E RAPORTIT TË SHPENZIMEVE BUXHETORE PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR PËR VITIN 2016

I

Miratohet raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar -Qershor për vitin 2016.

II

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është raporti i shpenzimeve buxhetore për periudhën Janar-Qershor 2016 i hartuar nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa. Buxheti i miratuar për vitin fiskal 2016 është në shumë prej 2,066,396.00 €, ndërsa ai përfundimtar është në shumë prej 2,195,489.66 € (duke përfshirë bartjen e të hyrave vetanake në shumë prej 129,093.66 €). Në kategorinë paga dhe mëditje shpenzimi është në shumë prej 695,159.35 € apo 50.87%, në kategorinë mallra dhe shërbime shpenzimi është në shumë prej 68,459.90 € apo 40.27% në kategorinë ekonomike shpenzime komunale shpenzimi është në shumë prej 25,451.66 € apo 52.14%, në kategorinë ekonomike subvencione dhe transfere shpenzimi është në shumë prej 17,900.00 € apo 33.43%, në kategorinë ekonomike shpenzime kapitale kemi shpenzuar 188,402.80 € apo 33.85%. Totali i shpenzimit është në shumë prej 995,373.71 € apo 89,572.54 € më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Të hyrat vetanake për periudhën Janar-Qershor janë arkëtuar në shumë prej 134,944.95 € apo 48.19% apo 16.04 % e planit të të hyrave.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Buxhet dhe Financa, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit

Data: 30.08.2016





Republika e Kosovës / Republic of Kosovo
Komuna - Municipality
Hani i Elezit



01/Nr. 8068 /2016

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11,12, 40, Ligjin Për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.04/L-144 neni 11, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me datë 30.08.2016 merr:

VENDIM
PËR KËMBIMIN E PRONËS

I

Kuvendi i komunës miratoi vendimin për këmbim të pjesës së parcelës kadastrale me nr.01192-1 zona kadastrale Seçishtë të evidentuara në çertifikatën e pronësisë nr.06-714-7922 /2016 datë:09.08.2016 në emër të P.SH Ujrat me parcelë kadastrale nr.01236-2 zona kadastrale Seçishtë të evidentuara në çertifikatën e pronësisë nr. 06-714-7923 /2016 datë:09.08.2016 në emër të z.Qamil Jashar Kalisi nga fshati Seçishtë- Hani i Elezit. Parcela kadastrale nr. 01192-1 pronë shoqërore zonë rurale me kulturë Prroni e klasit 0 (zero) në vendin e quajtur "Kodra " me sipërfaqe prej 01 18 95 ha e evidentuar në çertifikatën e pronësisë nr. 06-714-7922 /2016 zona kadastrale Seçishtë të evidentuar në emër të P.SH Ujrat. Një pjesë e saj parcelizohet i jepet një numër i ri me sipërfaqe prej 00 01 85 ha dhe tani bartet në emrin e z. Qamil Jashar Kalisi nga fshati Seçishtë- Hani i Elezit. Parcela kadastrale nr. 01236-2 pronë private zonë rurale me kulturë Arë e klasit 5 (pestë) në vendin e quajtur "Livadhi " me sipërfaqe prej 00 01 85 ha e evidentuar në çertifikatën e pronësisë nr. 06-714-7923 /2016 zona kadastrale Seçishtë të evidentuar në emër të Qamil Jashar Kalisi. Parcela kadastrale nr. 01236-2, pronë Private, zonë rurale me kulturë Arë e klasit 5 (Pesë), në vendin e quajtur "Livadhi ", me sipërfaqe prej 00 01 85 ha e evidentuar në çertifikatën e pronësisë nr. 06-714-7923 /2016 zona kadastrale Seçishtë, kalon në pronësinë e P.SH Rrugët.

II

Këmbimi bëhet për interesin e përgjithshëm që ka komuna për funksionimin e rrugës Hani i Elezit – Gorancë dhe anasjelltas.

III

Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës – MAPL-së dhe pas publikimit në faqen zyrtare të komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit , Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit

Data: 30.08.2016



Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava